

Angazhimi i OSHC – ve për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë kohës së Covid-19

Deklarata e ChildPact



ChildPact
SOLUTIONS FOR CHILD PROTECTION

28 Prill 2020

Pandemia Covid-19 ka ndryshuar mënyrën e jetës së njerëzve në të gjitha vendet e botës dhe në rajonin tonë. Të gjitha sistemet mbi të cilat janë ndërtuar shoqëritë tona janë sfiduar nga kjo krizë. Një analizë e kujdesshme kërkohet të bëhet për të kuptuar mirë mangësitë në sistemet që duhet të ndryshojmë për të siguruar mbrojtjen e duhur për fëmijët më të cenueshëm dhe realizimin e të drejtave të të gjithë fëmijëve. Kërkohet veprim i menjëhershëm dhe bashkëpunim i shtuar midis të gjithë akterëve për të zvogëluar ndikimin e krizës tek fëmijët në rajonin tonë dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre fizik dhe psikologjik.

Qeveritë, donatorët, OSHC-të, media dhe qytetarët ndajnë përgjegjësinë e përgjithshme për të mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës në të gjitha veprimet e ndërmarra për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar mbrojtjen e jetës dhe sigurinë e të gjithë fëmijëve, veçanërisht fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe fëmijëve refugjatë dhe migrantë.

Ndër shqetësimet tona më të mëdha janë:

- Përkeqësimi i rëndë i gjendjes nga rritja e varfërisë, që prek një numër të madh të fëmijëve dhe familjeve të cenueshme, shumë prej të cilëve tashmë janë duke përjetuar urinë
- Kufizimi i rëndë ose privimi i plotë në qasjen në shërbimet themelore si kujdes dhe ndihmë, edukim, mbështetje psikologjike, terapi, këshillim dhe rehabilitim, i një numri të konsiderueshëm të fëmijëve, veçanërisht fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve pa përkujdesje prindërore
- Rritje e konsiderueshme e ekspozimit të fëmijëve ndaj dhunës për shkak të bllokimit apo izolimit të zgjatur dhe/ose kushteve jo të mira të jetesës, si dhe ekspozim i fëmijëve ndaj dhunës në internet për shkak të rritjes së qasjes në internet dhe mbikëqyrjes së kufizuar
- Rritje e konsiderueshme e pabarazisë në qasjen në arsim, sidomos e fëmijëve nga familjet e cenueshme, fëmijëve pa përkujdesje prindërore ose fëmijëve në zonat urbane apo rurale të margjinalizuara për shkak të qasjes së kufizuar në internet dhe disponueshmërisë së pajisjeve adekuate elektronike
- Mos-përfshirja e OJQ-ve në planet organizative të qeverive për të zbutur ndikimin ekonomik të pandemisë aktuale, duke ndikuar në humbjen e pjesshme ose të plotë të të ardhurave të punonjësve të OJQ-ve dhe privimin e përfituesve nga mbështetja dhe shërbimet e ofruara nga OJQ-të.

Si një rrjet rajonal që ka mbi 650 OJQ me fokus fëmijët në rajonin e zgjeruar të Detit të Zi dhe Ballkanin Perëndimor, ChildPact konfirmon angazhimin e tij për të krijuar një rrjet të fortë të mbështetjes për OJQ-të që punojnë me fëmijë në rajonin tonë dhe të jetë një zë i mbështetjes për të gjithë fëmijët, veçanërisht fëmijët më të ekspozuar dhe më të ndjeshëm ndaj pandemisë Covid-19, dhe për OJQ-të që ofrojnë shërbime për mijëra fëmijë të cenueshëm në të gjithë rajonin. ChildPact mbështet kërkesat specifike dhe rekomandimet e nxjerra në nivel kombëtar nga anëtarët tanë në bashkëpunim të përbashkët me aktorët e tjerë.

SITUATA NË RAJON

Ne të gjithë jemi prekur nga pandemia Covid-19, por shpejtësia e veprimit të duhur dhe të guximshëm mund të shënojë ndryshimin midis tejkalimit të suksesshëm të situatës si dhe dështimit në mbrojtjen e fëmijëve tanë. Shumë shtete janë përpjekur për të mbajtur shërbimet për fëmijët dhe t'i përshtatin ato duke i ofruar online, si dhe kanë siguruar në kohë ekzekutimin e pagesave për përfitime sociale dhe skemave të mbështetjes financiare për fëmijët.

Në Gjeorgji shteti ka përgatitur hapësira të dedikuara për viktimat e dhunës, ndërsa në Armeni, Azerbajxhan dhe Kosovë, OSHC-të janë duke menaxhuar ose siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve emergjente. Në Armeni OSHC-të po kontribuojnë me burimet e tyre njerëzore në menaxhimin e zonave të karantinës të vendosura nga shteti dhe po organizojnë grupet e trajnuara mobile për të ofruar kujdes dhe mbështetje për fëmijët në zonat e karantinuara. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, OJQ Ndihmuese për Viktimat e Fëmijëve të Dhunës ka zgjeruar shërbimet e saj për të mbështetur fëmijët dhe qytetarët në kohën e Covid-19. Në Kosovë, strehimoret dhe shtëpitë me bazë në komunitet për fëmijë të udhëhequra nga OSHC-të po vazhdojnë të ofrojnë shërbime 24/7 dhe strehim për fëmijë pa përkujdesje prindërore, viktimat të abuzimit dhe trafikimit, ndërsa OSHC-të tjera të cilat ofrojnë shërbime sociale direkte për fëmijë, sikurse shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e përfshirë në punët e rënda kanë mbyllur shërbimet e tyre bazuar në vendimin e autoriteteve shtetërore, duke e transformuar punën e tyre në shërbime online.

Shumë OSHC në rajon ofruese të shërbimeve direkte kanë transformuar punën e tyre në seanca këshillimi online për fëmijë, mbështetje të prindërve dhe rritje të vetëdijësisimit. Në shumë vende qytetarët dhe OSHC-të janë mobilizuar në ofrimin e donacioneve për ushqim dhe furnizime themelore për famijët dhe familjet e cenushme. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, përveç veprimeve të gjëra humanitare, anëtarët e rrjetit kombëtar Stronger Voice for Children janë duke prodhuar maska falas për fytyrë, për mbrojtje nga Covid-19. Në Bullgari, Fondi i Bashkuar për Reagim Kundër Covid-19 është themeluar në Prill nga bizneset lokale dhe ndërkombëtare, individët, OSHC-të, ambasadat dhe Dhoma e Tregtisë, ku synojnë të ofrojnë ndihmë për OSHC-të të cilat po punojnë në komunat më të prekura nga shpërthimi i pandemisë. Përderisa, donacione për ndihmë mjekësore dhe kujdes social raportohet të jenë ofruar nga OSHC-të për institucionet shtetërore në Azerbajxhan, Moldavi dhe Rumani.

Rrjeti Kombëtar i Organizatave për Fëmijët e Serbisë MODS u ka dhënë fëmijëve mundësinë të shprehin ndjenjat dhe përvoja e tyre në lidhje me krizën aktuale dhe të shprehin sugjerimet dhe shqetësimet e tyre, duke siguruar një perspektivë të mirëfilltë dhe të nevojshme për proceset e vendimmarrjes gjatë krizës. Në Rumani, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Bullgari OSHC-të kanë kontribuar në mënyrë aktive në planifikimin dhe hartimin e politikave për zgjidhjen e krizës, ku sugjerimet e tyre pak a shumë janë marrë në konsideratë nga qeveritë.

Në shumë shtete shkollat janë mbyllur, ndërsa arsimiti po vazhdon përmes platformave online (në Gjeorgji, Moldavi, Serbi, Bullgari dhe Rumani). Turqia, Azerbajxhani, Kosova dhe Gjeorgjia po transmetojnë mësimin në televizionin kombëtar ndërsa Ministrinë e Arsimit të Azerbajxhanit dhe të Kosovës kanë vënë në dispozicion një platformë të dedikuar online për fëmijërinë e hershme.

Gjeorgjia me mbështetjen e UNICEF ka organizuar një linjë telefonike të veçantë për fëmijët dhe familjet për të marrë nevojat e tyre, referimin tek institucionet përgjegjëse për të mbështetur dhe për t'u përgjigjur nevojave të tyre, ndërsa qeveria ka ofruar pako bazike sociale për familjet e varfra, familjet me fëmijë dhe familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, disa vende kanë kufizuar ose pezulluar disa të drejta themelore të njeriut, sikurse monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike dhe realizimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti (veçanërisht Gjeorgjia apo Rumania). Në Turqi OSHC-të kanë kundërshtuar planin që të dënuarit për abuzim seksual dhe përdhunim mund të përfitojnë nga lirimi me kusht ose uljen e dënimit, si pjesë e masave për të parandaluar përhapjen e Covid-19. OSHC-të në Turqi raportojnë se fëmijët viktimë të abuzimit si dhe gratë dhe fëmijët të cilët janë viktimë të dhunës në familje kanë vështirësi në qasjen tek autoritetet gjyqësore.

Shumë pako ndihmë emergjente të ofruara nga qeveritë për të zbutur ndikimin negativ ekonomik si pasojë e pandemisë, përjashtojnë organizatat e shoqërisë civile si përfituese të mundshme, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose për shkak të kriteve të përshtatshme të ndërlidhura me bizneset (ky është rasti në Moldavi, Armeni, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Turqi). Në Kosovë, Pakoja Emergjente Fiskale e miratuar nga qeveria përfshin OSHC-të si përfitues të pagave (në mënyrë të pjesshme) si dhe qerasë për 2 muaj në kushte të caktuara. OSHC-të në Rumani kanë arritur të përfshijnë punëdhënësit si përfitues të skemave të mbështetura nga shteti për mbulimin e pagave në mënyrë të pjesshme.

Pas kërkesës së KOMF në Kosovë, qeveria ka aprovuar përfshirjen e Skemës për Përkrahje Materiale të Familjeve që kanë Fëmijë me Aftësi të Përhershme të Kufizuara dhe Skemës së Strehimit Familjar për Fëmijët pa Kujdes Prindëror tek të Afërmit në kuadër të Pakos Emergjente Fiskale.


Në Bosnje dhe Hercegovinë OSHC-të përfitojnë nga shfrytëzimi i hapësirës pa qira për dy muaj në komunën e Banja Llukës. Skemat e dedikuara të financimit për të mbështetur OSHC-të ndaj krizave (sigurimi i një edukimi të vazhdueshëm në distancë, ofrimi i shërbimeve emergjente për më të prekurit, etj.) janë në dispozicion në Moldavi, Gjeorgji, Armeni dhe Serbi. Donatorët aktivë në rajon janë: Central European Initiative Fund, Black Sea Trust, Komisioni Europian, Fondacioni Rinor Europian, UNICEF, USAID dhe Fondacioni Oak, ndërsa në Azerbajxhan disa fonde janë ndalur që nga fillimi i shpërthimit të pandemisë.

SFIDAT NE RAJON

Të drejtat themelore të fëmijëve janë duhet të adresohen gjatë masave ndaj Covid-19. Fëmijët nga familjet e ndara janë të privuar nga bashkëveprimi me prindin e tyre për shkak të kufizimit/bllokimit, ndërsa shumë fëmijë po përjetojnë neglizhencë në rritje dhe mbikëqyrje të ulur, veçanërisht në familjet e punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe profesionistëve të përfshirë në veprimet për menaxhimin e krizës.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në kujdes alternativ (veçanërisht të llojit institucional) preken në mënyrë të konsiderueshme nga izolimi, qasja e kufizuar ose nuk kanë fare qasje në shërbimet themelore siç janë arsimi, ndihma sociale, mbështetja psikologjike, terapia ose rehabilitimi, kanë raportuar OSHC-të në Moldavi, Gjeorgji, Armeni, Rumani dhe Serbi.

Në disa pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës fëmijëve nuk u lejohej të dilnin fare nga shtëpitë e tyre për javë të tëra, duke përjetuar kështu një periudhë të gjatë izolimi dhe shqetësimi, në kushte të ndryshme jetese, jo gjithmonë ndër më të mirat, me prindër me aftësi të ndryshme sa i përket komunikimit rreth pandemisë me fëmijët dhe me një qasje shumë të kufizuar ose pa qasje në shërbime të specializuara mbështetëse në këtë drejtim. Në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë, fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë marrë shërbime të rregullta psikologjike dhe sociale, rehabilitim fizik në qendrat e kujdesit ditë kanë mbetur pa qasje në shërbime, pasi këto shërbime janë mbyllur për shkak të situatës pandemike. Disa OSHC kanë filluar të ofrojnë shërbime online për fëmijët.



Në Bosnjë dhe Hercegovinë, OSHC-të kanë filluar punën përmes internetit me fëmijët përfitues të Qendrave për fëmijë në rrezik dhe fëmijë që punojnë/jetojnë në rrugë.

Periudha e zgjatur e izolimit apo bllokimit ka ndikuar në rritjen e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe grave, kanë raportuar shtetet si Moldavia, Gjeorgjia, Armenia, Serbia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Rumania. Kushtet jo të mira të jetesës dhe vështirësitë financiare janë duke favorizuar dhunën ndaj grave dhe fëmijëve.

Pabarazi në rritje e qasjes në arsim për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të pajisjeve dhe qasjes në internet në zonat rurale dhe zonat urbane të marginalizuara, dhe në mesin e familjeve të cenueshme raportohet në Moldavi, Gjeorgji, Serbi, Armeni, Bullgari, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Rumani.

Ekzistojnë dallime domethënëse në cilësinë dhe sasinë e kontaktit ndërmjet mësuesve dhe fëmijëve që ndikojnë në aftësinë e fëmijëve për të mësuar në shtëpi, thekson sondazhi i aplikuar për fëmijët në Serbi. Sfidat për të mësuar në shtëpi janë rritur nga përdorimi i shumë aplikacioneve të ndryshme, kufizimeve të pajisjeve në dispozicion, shkallës së "miqësisë" ndaj përdoruesit dhe përvojës me aplikacionet dhe mjetet e mësimi online. Përdorimi i shtuar i internetit dhe kufizimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes së prindërve dhe ofruesve të përkujdesjes çon në ekspozimin e fëmijëve ndaj përmbajtjes së papërshtatshme, lojërave të rrezikshme, abuzimit seksual dhe ngacimit në internet. Në Bosnjë dhe Hercegovinë që nga fillimi i muajit Prill 2020, anëtarët e rrjetit SVC ofrojnë çdo ditë mundësi arsimore dhe argëtuese në internet për fëmijë dhe mësime të mësuara.

Shumë OSHC në rajon janë të shqetësuara për rritjen e varfërisë në situatën aktuale, duke prekur familjet tashmë të cenueshme. Në shumicën e vendeve të rajonit, humbja e vendeve të punës dhe të ardhurave rrit rrezikun e neglizhencës së fëmijëve, abuzimit dhe madje braktisjes për shkak të kufizimit të aftësisë së prindërve për të siguruar kujdes të duhur për fëmijët. Të gjitha këto rrethana krijojnë më shumë nevojë për mbështetje psikologjike për fëmijët dhe familjet, në mënyrë që ata të mund të përballen me izolimin, shqetësimin dhe ndjenjën e pasigurisë të krijuar nga pandemia.

Në të njëjtën kohë, mungesa e profesionistëve të trajnuar në ndihmë dhe përkujdesje sociale, mbështetje psikologjike, këshillim dhe rehabilitim po bëhet gjithnjë e më e dukshme në kushtet e krizës. Niveli i aftësive prindërore të prindërve dhe ofruesve të kujdesit luan një rol kryesor në komunikimin adekuat me fëmijët dhe aftësinë e prindërve për të siguruar rehati dhe ndjenjën e sigurisë për fëmijët, duke treguar rëndësinë e edukimit të prindërve në të gjitha vendet e rajonit.

REKOMANDIMET

Për Qeveritë

- ❖ Përfshini OShC-të në masat për mbështetje emergjente për tejkalimin e sfidave ekonomike të krizës
- ❖ Bashkëpunoni me OShC-të për identifikimin dhe mbështetjen e familjeve që janë në rrezik të lartë (familje me prindër beqarë, familje që jetojnë në varfëri, familje me të ardhura të ulëta, familje të marginalizuara, familje me kushte jo të duhura të jetesës etj.)
- ❖ Mbështetni OShC-të në organizimin e vullnetarëve për të ofruar ndihmë për personat në rrezik (Të përfshihet vullnetarizmi në listën e aktiviteteve të lejuara, të ofrohen pajisje që shërbejnë për sigurinë e vullnetarëve, të ofrohet hapësirë dhe bashkëpunim nga ana e institucioneve publike që punojnë me grupe të cenushme për të pranuar OSHC-të dhe mbështetjen e vullnetarëve në përputhje të plotë me udhëzimet e sigurisë)
- ❖ Siguroni qasje falas në internet dhe pajisje për fëmijët e familjeve në nevojë, zona rurale ose kujdes rezidencial dhe alternativ për të siguruar qasjen e tyre në arsim
- ❖ Identifikoni dhe zbatoni masat që do të siguronin zgjidhje të qëndrueshme për problemet siç janë strehimi adekuat dhe qasja në ujë të pijshëm, që prek mijëra fëmijë.

Për Donatorët

- ❖ Rregulloni procedurat administrative për grantet dhe siguroni proces të lehtë të aplikimit dhe raportimit për të mundësuar fokusim të plotë të kohës dhe aktiviteteve më shumë në ndërhyrje në këtë situatë, sesa në kërkesa administrative
- ❖ Qasuni në mënyrë fleksibile në lidhje me projektet dhe programet që janë aktualisht nën zbatim duke lejuar ndryshime në llojin e aktivitetit dhe alokimet e buxhetit duke u përshtatur me situatën aktuale (zëvendësimi i aktiviteteve “sy më sy” me aktivitete alternative, zhvendosja e buxhetit drejt mbështetjes dhe ndihmës emergjente, etj.)
- ❖ Ofroni mbështetje për aktivitetet administrative të OSHC-ve përmes granteve të vogla, duke përfshirë por pa u kufizuar në kostot e zyrës, menaxhimin administrativ dhe financiar, kostot e komunikimit (telefoninë fikse dhe mobile, internet, etj.) pasi që shpenzimet administrative janë rritur për shkak të përpjekjeve të OSHC-ve për të mobilizuar vullnetarët dhe për të ofruar ndihmë për personat më të prekur

Për Mediat

- ❖ Përshtatni komunikimin për fëmijë, duke shmangur sensacionin dhe dramën gjatë mbulimit mediatic
- ❖ Komunikoni me mençuri realitetin aktual duke u bazuar në informacion të saktë, të plotë dhe të kontrolluar në mënyrë të dyfishtë
- ❖ Ofroni hapësirë pro-bono (radio, TV, gazetë) për aktivitete edukative, mbështetje të vullnetarëve dhe ekspozimin e lajmeve pozitive që mund të ndihmojnë popullatën të përballojë më lehtë stresin dhe izolimin e shkaktuar nga kriza

RRETH CHILDPACT

ChildPact është një rrjet rajonal i rrjeteve nacionale të OJQ-ve që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve, aktiv në 11 vende në rajonin e zgjeruar të Detit të Zi, e që është themeluar në kuadër të Forumit të OJQ-ve të Detit të Zi. Vizioni i ChildPact është një botë në të cilën çdo fëmijë përfiton nga mbrojtja e qasshme, e përballueshme dhe e vazhdueshme brenda dhe jashtë mjedisit familjar. Misioni i ChildPact është të ndryshojë jetën e fëmijëve duke frymëzuar krijimin dhe zbatimin e politikave transformuese të mbrojtjes së fëmijëve. ChildPact beson në fuqinë e bashkëpunimit rajonal për të sjellë përmirësime në situatën e fëmijëve në rajon.

ANËTARËT E CHILDPACT

All Together for Holistic Care of Children (BKTF) / Shqipëri (<https://bktfcoalition.org/en/>)

Child Protection Network / Armeni (<http://armeniachildprotection.org/>)

National Network for Children / Bullgari (<http://nmd.bg/>)

Coalition for Children and Youth / Gjeorgji (<http://ccy.ge/>)

Coalition of NGOs for Child Protection (KOMF) / Kosovë (<http://komfkosova.org/>)

Alliance of Active NGO's in the field of Child and Family Social Protection (APSCF) / Republika e Moldovisë (<http://www.aliantacf.md/>)

Federation of NGOs for Child / Rumani (<http://www.fonpc.ro/>)

Network of Civil Society Organizations for Children of Serbia (MODS) / Serbi (<http://zadecu.org/?lang=en>)

ANËTARËT E ASOCIUAR TË CHILDPACT

Azerbaijani NGO Alliance for Children's Rights / Azerbaixhan (<http://ngoalliance.net/en/>)

Stronger Voice for Children (SVC) / Bosnie dhe Hecegovinë (<http://eng.snaznijglaszadjecu.org/>) Association to End Child Sexual Abuse and Exploitation ECPAT (Turqi) (www.ecpatr.org)

DEKLARATAT E PLOTA TË ANËTARËVE TË CHILDPACT

BULLGARI: [THE NATIONAL NETWORK FOR CHILDREN CALLS FOR URGENT MEASURES TO LIMIT THE RISK FOR CHILDREN AND FAMILIES DURING COVID 19 CRISIS](#)

RUMANI: [THE IMPACT OF ISOLATION ON CHILDREN, INCLUDING THE “INVISIBLE” CHILDREN](#)

SERBI: [BEING A CHILD DURING COVID-19 PANDEMIC](#)

SHQIPERI: [REQUEST FOR FINANCIAL SUPPORT TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS TO COPE WITH THE SITUATION CREATED BY COVID-19](#)

BOSNIE DHE HERCEGOVINË: <http://snaznijiglaszadjecu.org/blog/2020/04/27/ngo-request-for-revision-of-the-proposal-of-the-fbih-corona-law-2020/>

KOSOVË: [KOMF LETËR MINISTRIT TË FINANCAVE PËR PLOTËSIM TË PAKOS EMERGJENTE FISKALE](#)